



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/71  
Datë: 26.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 prill 2022, merr këtë:


**V E N D I M**

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.02/50 i datës 23 dhjetor 2021, si vijon:
  - Pika 2. nënpika 72: "Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr.11/2014 për Themelimin, Zgjedhjen, Përgjegjësitë dhe Funkcionimin e Këshillit për Fshatin Hoçë e Madhe;
  - Pika 2. nënpika 81: "Udhëzimi Administrativ Nr.03/2013 për Këshillin Zbatues dhe Monitorues;
  - Pika 2. nënpika 73: "Udhëzimi Administrativ Nr.12/2014 për Themelimin, Zgjedhjen, Përgjegjësitë dhe Funkcionimin e Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit dhe të Zyres së Qendrës Historike të Prizrenit";
  - Pika 2. nënpika 255: "Udhëzimi Administrativ Nr.10/2011 për Regjistrimin dhe Licencimin e Profesionistëve Shëndetësorë;
  - Pika 2. nënpika 250: "Udhëzimi Administrativ Nr.12/2013 për Vendosjen e Banderolave në Produktet Medicinale";
  - Pika 2. nënpika 293: "Udhëzimi Administrativ Nr.15/2003 për Pagesat e Ekspertëve Profesionalë dhe Komisioneve Funktionale"; dhe
  - Pika 2. nënpika 251: "Udhëzimi Administrativ Nr.13/2013 për Qarkulluesit me Shumicë për Produktet dhe Pajisjet Medicinale", mbesin në fuqi deri në nxjerrjen e akteve të reja nën ligjore apo plotësim-ndryshimit eventual të legjislacionit primar, në qëllim të shmangies së vakumit juridik.
2. Udhëzimet Administrative nga pika 1. e këtij Vendimi, do të llogariten si në fuqi që nga dita e hartimit të tyre, duke anashkaluar në plotëni Vendimin Nr. 02/50 të datës 23 dhjetor 2021 për sa i përket zbatimit të tyre.
3. Ky Vendim është pjesë e Vendimit të Qeverisë Nr. 02/50 të datës 23 dhjetor 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 05/56 të datës 26 janar 2022 dhe Vendimin e Qeverisë Nr. 05/70 të datës 21 prill 2022.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PER



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë